



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 30, datë 28.10.2021

**Për miratimin e pasqyrave financiare të
Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
për tremujorin e tretë të mbyllur më 30 shtator 2021**

Në mbështetje të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1” të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, nenit 71, pika 2, të nenit 73, pika 1, dhe të nenit 79, pika 1 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 15, pika 1 dhe pika 5 të Vendimit nr. 56, datë 3.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të ndryshuar, si dhe nenit 6, pika 2, shkronja “c” dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “l” e Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 18, pika 2, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Të miratojë pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për tremujorin e tretë të mbyllur më 30 shtator 2021, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar